




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-0/DPK	Nr. Prot. Bi Prot. 01-3551/15
Nr. i faq. Broj stranica 03	Data Datum 23.10.2015
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	22.10.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPK 03-02/2849/15
PËR/ZA/TO:	z. Elmi Kelmendi - Zyrtar i Lartë Ligjor në Agjencinë e Kosovës për Akreditim
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik

I nderuari z. Kelmendi,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 nën paragrafi 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me kërkesën tuaj për opinion, me numër protokoli DPKI 03-2849/15, për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, në rastin kur ju, krahas funksionit të zyrtarit të lartë ligjor në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës, angazhoheni në cilësi të ligjëruesit në ndonjë institucion të arsimit të lartë, jashtë orarit të punës, bazuar në informacionet e ofruara nga ana juaj Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik nuk ka parashikuar ndonjë ndalesë në këtë situatë.

Arsyetim

Bazuar në Ligjin PKI, i cili ka rregulluar çështjen e parandalimit të konfliktit të interesit për zyrtarët e lartë, nuk është i ndaluar ushtrimi i punëve nga lëmi i shkencës. Për më tepër, ky ligj, shprehimisht e ka lejuar ushtrimin e këtyre punëve, nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera.

Në nenin 10 (pika 2) të Ligjit PKI parashihet se: *gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, zyrtari i lartë mund të ushtrojë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarisë humanitare, nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera.*

Në këtë rast mund të paraqitet konflikti “rast për rast” i interesit, i cili është parashikuar në nenin 13 të Ligjit PKI.

Neni 13 ka përcaktuar se:

1. Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit.

2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa me shpejt që të jetë e mundur.

3. Vetë deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.

Mirëpo, meqenëse ju nuk hyni në kategorinë zyrtarëve të lartë publik të paraparë në nenin 4 të Ligjit PKI, ne ju sugjerojmë që të veproni konform Rregullores nr. 04/15 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, konkretisht, në pajtim me nenin 16 të kësaj rregulloreje, e cila ka parashikuar dispozitat si më poshtë:

Angazhimi i nëpunësit civil jashtë institucionit

1. Me veprimtari të jashtme të nëpunësit civil kuptojmë çdo lloj angazhimi të rregullt ose të kohë pas kohshëm jashtë institucionit me pagesë ose pa pagesë.

2. Nëpunësi civil nuk duhet të angazhohet në një veprimtari të jashtme, që pengon kryerjen e detyrës së tij zyrtare dhe që cenon në çfarëdo mënyre, realizimin e objektivave të institucionit.

3. Nëpunësi civil për angazhimin e jashtëm duhet t'i njoftoj paraprakisht udhëheqësin drejtues dhe njësinë e personelit.

4. Angazhimi i nëpunësit civil në kuadër të veprimtarive sindikale ose të përfaqësimit të nëpunësve civil ose veprimtaritë mësimdhënëse, hulumtuese dhe trajnuese, janë të lejueshme kur ato nuk pengojnë në kryerjen e detyrës dhe nuk bien ndesh me natyrën e punës.

5. Qeveria sipas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratë publike përcakton rregullat e klasifikimit të një veprimtarie të jashtme si të lejueshme ose jo.

Me respekt!

